

VENDIM
Nr. 105, datë 15.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT
SOCIAL SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, nenit 100, të Kushtetutës, dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalía e fundit riformulohet, me këtë përmbajtje:

“Në listën e inventarit të pronave, bashkëlidhur vendimit nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, emri i pronës “Godina e Shtëpisë së Foshnjës Shkodër” zëvendësohet me “Godina e Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër” dhe funksioni për të cilin përdoret prona ndryshohet në “Qendër rezidenciale për fëmijë 0-6 vjeç”, dhe emri i pronës “Godina e Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër” zëvendësohet me “Godina e Shtëpisë së Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër” dhe funksioni për të cilin përdoret prona ndryshohet në “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç”.

2. Ngarkohet kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama